

FJALA E DEPUTETIT SHPËTIM IDRIZI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Në fakt, është mungesë serioziteti që në ditën më të rëndësishme të këtij parlamenti, pra të diskutimit për buxhetin, ne të rrimë 4 orë dhe të dëgjojmë këtu lloj-lloj historish e gjërash, që nuk kanë lidhje me buxhetin. Dhe, mbi të gjitha, më bën përshtypje, ky është buxheti i 13-të që kaloj unë, që është hera e parë që votohet buxheti dhe pastaj flitet në emër të grupeve. Gjithsesi, në respekt të qytetarëve, më duhet të vazhdoj dhe të them se, fatkeqësisht, nga ajo që ka ndodhur këtu këto ditë, kur neve na duhej, në fakt, një debat jopartizan, sepse pasi të ketë mbaruar i gjithë ky diskutim, ne do të mbajmë mend kacafytjet, batutat dhe jo çfarë është mirë apo keq në këtë buxhet, çfarë duhet të përmirësohet apo duhet të hiqet nga ky buxhet, cilat janë prioritetet apo ato zëra që mund të presin, apo ku e nxitim ekonominë dhe ku e rrezikojmë atë. Siç ka ndodhur, në fakt, në 30 vjet tranzicion, gjithmonë kam parë që këtu janë 70 e ca deputetë, që thonë se ky është buxheti më i mirë dhe më i madh i të gjitha kohërave, dhe 60 e ca deputetë të tjerë që e anatemojnë atë. Në fakt, ky buxhet nuk është as buxheti më i mirë, as buxheti më i keq, por është një buxhet si të gjithë të tjerët, që pasqyron pikërisht këtë realitet të zymtë ku ne jetojmë: me shumë varfëri, me rroga nga më të ulëtat në rajon, me pensione që nuk dalin as për të mbajtur frymën gjallë, por edhe me disa shpenzime dhe investime publike që, në fakt, do t'i kishin zili edhe shtetet më të pasura.

Ne sot jetojmë mbi një realitet ekonomik pesimist, me të gjitha avantazhet që natyra dhe Zoti i kanë dhënë këtij vendi. Ne mbetemi një nga vendet më të varfra në Europë, ku të ardhurat për frymë janë vetëm 31% të mesatares së BE-së. Prandaj ju them se ne na duhet një debat tjetër, komplet ndryshe, ndërkohë që kemi një buxhet, ku 800 milionë janë borxhe apo deficit, kemi një buxhet që nuk i fusim në llogari 1,3 milionë shqiptarë, që janë në emigracion dhe që sjellin 800 milionë deri 1 miliard euro në Shqipëri dhe mburremi se si do t'i ndajmë apo si do t'i copëtojmë. Sigurisht, kjo gjë ka ndodhur në 30 vjet dhe unë po ju them që buxhetin nëpër ministri e ka ndarë drejtoresha e buxhetit në Ministri të Financave. Por, në qoftë se ne do të na e ndajnë buxhetin pa një filozofi ekonomike, po thjesht me matricën e FMN-së për ndarjen në raport me GDP-së, por ju them që ju mjafton një student i Fakultetit Ekonomik. Ajo për të cilën ne duhet të hapim një debat ka të bëjë me një model të ri zhvillimi që bazohet mbi prodhimin, narracionin dhe jo thjesht atë që keni bërë deri më sot: rritjen ekonomike. Për këtë ne na duhet të bëjmë sot një debat publik për profilin e ekonomisë shqiptare, të bënim një debat se cilat janë avantazhet dhe prioritetet e ekonomisë shqiptare, qoftë edhe duke konkurruar me ato që s'po konkurrojmë dot, me vendet e rajonit dhe, mbi të gjitha, si do t'i mbështesim dhe si do t'i nxisim këto përparësi.

Ne kemi 30 vjet që bëjmë një buxhet, një politikë ekonomike etatiste, ku thjesht kemi synuar një rritje ekonomike nëpërmjet politikave të ashtuquajtura "politika të rritjes" apo "të rritjes së kërkesës" apo "të rritjes së konsumit", të cilat janë politika që e shohin shtetin në rol primar nëpërmjet politikave fiskale dhe monetare, me ngritje taksash, ngritje-ulje normash interesi, rritje të shpenzimeve qeveritare, investime apo fryrje të administratës. Të nderuar kolegë, për 30 vjet është provuar se ka qenë një politikë ekonomike e dështuar nga të gjitha qeveritë. Ndoshta mund të ketë sjellë edhe rritje ekonomike, por asnjëherë ajo nuk është përkthyer në një rritje cilësore dhe në mirëqenie për qytetarët. Vendosija e shtetit në rolin e nxitjes së konsumit, pra të kërkesës dhe jo të operatorëve ekonomikë në treg apo të individëve, që janë motori real i kësaj ekonomie, ka nxitur për 30 vjet

autoritarizmin, korrupsionin, mungesën e konkurrencës, varësinë e njerëzve nga qeveria dhe, rrjedhimisht, një emigracion masiv. Sot që një i ri të punësohet, nuk ka nevojë të futet dhe të shohë se ku është në tregun e dijes, por mjafton të jetë i identifikuar si mbështetës i qeverisë. Sot që të zhvillohet një biznes, nuk ka nevojë të konkurrojë me ide, të konkurrojë me kapital financiar apo kapital njerëzor, por mjafton të jetë i identifikuar si mik i qeverisë. Prandaj ne sot shohim se të gjithë duan të punësohen në shtet, apo të ikin në emigracion. Ka edhe një zgjidhje tjetër, që do të ishte debati real për buxhetin sot në këtë parlament, sot ne duhej të bënim një debat për modelin ekonomik që të bazohet te rritja e prodhimit dhe të bazohet në politika që do të rritin ofertën për mallra dhe shërbime në treg, politika që do të rritin ofertën dhe që mbështeten në prodhimin vendës, ulje taksash, e deregulim të një tregu pa konkurrencë dhe të kapur dhe, sigurisht, me investime në një arsim cilësor dhe të orientuar nga tregu i punës. Në infrastrukturë, pa dyshim, por edhe në shfryrjen e administratës dhe uljes së shpenzimeve qeveritare.

Sot Shqipëria nuk prodhon asgjë. Edhe domatet, specat, kastravecët, por edhe ushqimet, fatkeqësisht i importojmë nga jashtë. Sigurisht, e thashë edhe më sipër, nëse nuk do të flasim këtu në lidhje se me ku e se si do të shtrihen fondet apo do të ndahen nëpër ministri, se do të ulim e do të ngremë ca të tjera, pa dyshim që nuk kemi bërë asgjë, sepse ne na duhet një model ekonomik i ri zhvillimi, i bazuar pikërisht mbi prodhimin, sepse me këto ritme zhvillimi, e kemi pasur gjithë këto vite 3-4 % rritje, një rritje anemike, e cila s'është përkthyer asnjëherë në mirëqenie për shqiptarët. Me këto ritme rritjeje, duke qenë se paga e një shqiptari është vetëm 30 % e pagës mesatare të Bashkimit Europian, pa dyshim që do të na duhen dhjetëra e qindra vite për të arritur vendet e BE-së, ku aspirojmë të jemi. Sigurisht, një politikë buxhetore pa prioritete dhe pa orientim ka sjellë amulli edhe në politikën fiskale.

Ne shohim politikën e taksave, e cila ka si qëllim në vetvete pikërisht të rrisë të ardhurat, jo si instrument ekonomik për të nxitur zhvillimin në sektorët prioritarë të ekonomisë. Politikën fiskale janë dalluar dhe janë karakterizuar gjithmonë nga ndryshime të shpeshta e të paqëndrueshme. Ato janë kthyer nën një kosto shtesë për operatorët ekonomikë, sidomos për programimin e tyre. E kam dëgjuar prej shumë kohësh, e kanë pasur demagogji që gjoja ne këtu ndahemi në të majtë e në të djathtë, se dikush është për taksën e sheshtë, dikush është për taksën progresive. Jo, të nderuar deputetë: në sistemin tonë fiskal ka vetëm një taksë, e cila është taksë progresive. Çuditërisht, për një qeveri të majtë është tatimi mbi të ardhurat personale. Të gjitha taksat e tjera janë taksë e sheshtë. Po të marrim taksën e korporatave të biznesit, është taksë flat, 15 %. Është vërtet çudi e madhe, se si një maxhorancë socialiste takson më shumë punën dhe konsumin se sa kapitalin. Pra, jo vetëm nuk qëndron se kemi taksë progresive, e cila është e majtë, por ju lutem, sepse është e kundërta, ndaj mos u mburrni më me këtë gjë. Po të shohim të ardhurat nga doganat apo nga sistemi tatimor, çuditërisht të ardhurat doganore janë ende shumë të mëdha në krahasim me të ardhurat tatimore. Ky është tregues që, ose sistemi fiskal i mbledh të ardhurat aty ku i ka më kollaj, shumë herë edhe në mënyrë arbitrare, ose ne varem totalisht nga importi, sepse ky vend nuk prodhon asgjë. Në fakt, unë mendoj se janë të dyja. Ne jemi një ekonomi që nuk prodhon, madje edhe produktet ushqimore i importojmë, sepse edhe këtu shohim që janë të kapur nga monopolet.

Kur po flisja për bujqësinë, pa dyshim besoj se mungojnë politikën e qëndrueshme. Kam parasysh faktin që sot, teksa ne po flasim, fermerët e Lushnjës janë duke protestuar. Ne kemi parë rëndom që sa herë vjen cikli kohor i produkteve, fermerët dalin dhe i hedhin produktet e tyre, sepse nuk kanë mundësi t'i tregtojnë (sepse këtu nuk flitet për një zinxhir, i cili fillon me prodhimin e deri te konsumatori), ose grumbulluesi ua blen me çmime qesharake. Nëse do ta lidh me politikën fiskale dhe ta shihnim bujqësinë si prioritet, atëherë si shpjegohet rritja me 6 lekë e çmimit të gazit apo heqja e TVSH-së me 6% (nga 20 shkoi në 6 dhe sot u hoq) për produktet bujqësore, duke ua lënë koston fermerëve, si dhe heqja e TVSH-së në masën 20% për makineritë dhe pajisjet që do të përdoren pikërisht për prodhim?

Pra, po ju jap 2-3 shembuj si ilustrim, sepse, nga një anë, thuhet që kjo është përparësi dhe, nga ana tjetër, bëhet një politikë rokoko. Nuk arrij ta kuptoj dot, sigurisht, kemi mangësi të mëdha në këtë strukturë të ekonomisë, se si lopët shqiptare e nxjerrin qumështin me një kosto më të lartë sesa lopët e Serbisë. Kjo është shumë e thjeshtë për ta shpjeguar, sepse ne jo vetëm që nuk arrijmë dot që nga prodhimi në grumbullim dhe të dalë në treg, por në të njëjtën kohë nuk kemi as masa profesioniste mbrojtëse për produktin vendas. Të gjithë e dinë shumë mirë, edhe për çështjen që ju fola, por edhe për produkte të tjera ushqimore, ato na vijnë nga Serbia apo nga vende të tjera fqinj, sepse çmimet janë të subvencionuara, pra shiten nën kosto. Çfarë bën shteti ynë? Pa dyshim që duhet të marrë masa proteksioniste për këtë gjë. Më bëri përshtypje një fakt, vendosja e një takse prej 1 mijë lekësh për qumështin pluhur. Nuk e di nëse u hoq edhe ajo dhe nuk arrij ta kuptoj se kush e bëri këtë lloj lobimi. Janë disa tregues, të cilët po i marr pikërisht për t'ju ilustruar se ne nuk mund të ecim dot pa një model ekonomik zhvillimi, pa prioritete, pa pavarësi edhe kur ne ndihemi më të fortë që të konkurrojmë. Po me kë? Jo me ndonjë në tregun e rajonit, sepse po na del që mandarinat e Konispolit, mallrat e Dibrës apo të Korçës sa herë që vjen sezoni, fillojnë të mos shiten në treg, sepse nuk ka kush t'i konkurrojë, siç mund të jetë molla e Maqedonisë apo e Greqisë. Këtu duhet shteti. Ju në politikat e zhvillimit nuk i bëni dot, por të paktën t'i bëni në masat mbrojtëse dhe proteksioniste. E them në këtë mënyrë, pasi ne jemi një vend ku sipas Eurostatit, 50,8% e shqiptarëve janë në rrezikun e varfërisë apo të përjashtimit social, ku 30% e shqiptarëve jetojnë në kufijtë e varfërisë me vetëm 5 dollarë në ditë, ndërkohë nga krahu tjetër jemi një vend që kemi borxhin publik, 80% thotë qeveria, por, nëse këtij borxhi do t'i shtojmë PPP-të, vendimet e arbitrazhit, por edhe të gjithë borxhin e papaguar karshi biznesit, do të shkojë në 100% të GDP-së dhe do të jetë një risk shumë i madh për ekonominë shqiptare.

Sigurisht që kjo ka sjellë edhe një mungesë shprese dhe një ambient të pafavorshëm ekonomik, që është përkthyer edhe me një hemorragji të emigracionit. Po ashtu, kjo ka sjellë probleme të mëdha edhe në sistemin e pensionistëve dhe në tregun e punës. Sot në Shqipëri jetojnë, sipas statistikave, po e marr si të mirëqenë, 2,8 milionë shqiptarë. Kemi qenë 4 milionë shqiptarë në vitin 1990, por është e pafalshme që 700 mijë kanë ikur në 9 vjetët e fundit. Moshë mesatare në vitin 1990 ishte 26 vjeç, sot është mbi 40 vjeç. A e kuptoni ju çfarë problemesh të mëdha e lidhin demografinë me ekonominë? Por të mos harrojmë se këta emigrantë, të cilëve ia hoqëm edhe Ministrinë e Diasporës, janë prej 30 vjetësh dhe kontributorët më të mëdhenj në ekonominë shqiptare. Ne nuk prodhojmë asgjë, ne jemi një konvikt i madh, ne mbahemi me remitancat e 1,3 milionë shqiptarëve që janë jashtë dhe me 800 milionë ose 100% të GDP-së të borxhit publik. Nuk mund të vazhdojmë kështu. Sigurisht nuk mund të vazhdojmë kështu. Pra, thashë që historikisht prej 30 vjetësh ne kemi rritur kërkesën duke bërë disa investime, që nuk dimë a kanë efektivitet në ekonomi dhe nuk jemi marrë me rritjen edhe me prezantimin e ofertës që vjen vetëm nga prodhimi vendas.

Dua të ngre edhe një çështje tjetër, që lidhet me pensionet. Sot sistemi i pensioneve jo vetëm që është qesharak, kur prindërit tanë marrin pension 70 - 100 mijë lekë, por duke paguar ujin, dritat dhe ilaçet nuk e di si jetojnë. Sot për pensionin e një qytetari, që ka punuar 40-50 vjet, duhet të kontribuojnë 3 të punësuar, por, kur të gjithë ikin, është shumë e vështirë që kjo të ndodhë. Po mundohem ta përmbledh, zonja Kryetare, por kam edhe një element të rëndësishëm. Në buxhet për emergjencat civile janë parashikuar vetëm 500 milionë lekë. Sigurisht që tashmë përmbytjet, bora, zjarret, nuk janë më gjëra që ndodhin rastësisht, por janë bërë normale për vendin tonë. Ne e dimë shumë mirë që do të ndodhin edhe zjarret, edhe përmbytjet, por nuk e kuptoj dot pse nuk ngremë një ministri për emergjencat civile, me një buxhet të plotë, sepse e pamë kur ra tërmeti që nuk gjendeshin dot as kasma, apo kur digjeshin pyjet pamë drejtorin e Emergjencave Civile që kishte marrë një degë peme për të shuar zjarret. Sigurisht që ne kemi mundësi të jemi një shtet më serioz me të gjitha këto gjëra. Për të mos u ndalur gjatë te PPP-së, sepse i përmendën parafolësit, do të them vetëm një gjë. Sigurisht

që PPP-të nuk janë gjithmonë për t'i anatemuar, por nëse ne shohim rentabilitetin dhe marrim 200 kompanitë më të mëdha, fitimin më të madh prej 25 % të garantuar nga shteti e kanë kompanitë që kanë marrë këto koncesione, kurse të tjerët në biznes që rropaten si, për shembull, fasonët, ushqimoret e kanë 26% normën e fitimit dhe këta e kanë fitim të garantuar. Por shihini të gjitha kompanitë që i marrin, edhe ato që janë rankuar me 20-30 ose 100 kompanitë e mëdha, asnjë prej tyre nuk është kompani që përbën vlerë të shtuar, asnjë prej tyre nuk është kompani që prodhon, por janë kompani të shitjes me pakicë a shumicë, shërbime dhe ndërtim, pra janë thjesht këpusha në buxhetin e shtetit. Ky është problemi më i madh: kemi deformuar tregun. Të gjitha paratë po shkojnë në duart e 5 vetave dhe ne e dimë shumë mirë se një treg pa konkurrencë nuk ekziston. Kam edhe një fjali dhe po e mbyll, zonja Kryetare. Më ka bërë shumë përshtypje se kompanitë jashtë dedektojnë të hyjnë në fakultet studentët e mirë. U paguajnë, madje me bursa të plota, shkollimin, sepse kanë nevojë që kapitalin financiar ta bashkojnë me kapitalin njerëzor. Sot a keni parë ndonjë prej kompanive tona të shkojë në fakultet dhe të gjejë ndonjë që është i zoti dhe i mirë? Jo! Pse? Sepse edhe të rinjtë thonë: "Më mirë po futemi në një parti politike dhe po zëmë një vend pune". Edhe kompanitë nuk dallohen nga njëra-tjetra, sepse nuk kanë konkurrencë, nuk dallohen nga risku, inovacioni, pra mjafton që të jesh mik dhe klient i qeverisë.

Ju falënderoj për kohën, zonja Kryetare! Të nderuar kolegë, Jam menduar shumë se si ta mbyll këtë buxhet. Sigurisht që insisto, se na duhet një debat për një model të ri ekonomik zhvillimi drejt prodhimit. Na duhet një model ekonomik që ne të shohim përparësitë e ekonomisë shqiptare. Fatkeqësisht, unë ju ftoj sot që të mos e shohim këtë projektbuxhet si ai skeçi i famshëm "Si do të ndahen 28 kamionë për 7 batalione", por si mundësi zhvillimi për modele ekonomike. Fatkeqësisht, po shoh këtë radhë që ne i kemi nisur 8 kamionë që t'i ndajmë për 7 batalione. Ju faleminderit!